- d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Për operatorët ekonomik që kanë në objektin e veprimtarisë prodhimin e mobiljeve të drurit, duhet të paraqitet **Leja Mjedisore** (Autorizim Mjedisor) të lëshuar nga organet kompetente për veprimtarinë në fushën e objektit të prokurimit. (në rast se është prodhues).
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, **ISO 9001-2015**.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë **OHSAS 18001:2007**.

*Çertifikatat të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. **Xhiroja mesatare vjetore** gjatë tre viteve të fundit, të ketë një vlerë sa 30% e fondit të Marrëveshjes Kuadër. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin nga Administrata Tatimore për xhiron e realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës ose kopje të deklaratave të xhiros vjetore të operatorit ekonomik të tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **kopje të certifikuara të bilanceve** të tre viteve të fundit (2015, 2016, 2017) të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej

minimalisht 30 % të vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër. Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë **faturën përkatëse tatimore** të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, në rast se është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar për periudhën janar - gusht 2018, një **staf punonjësish minimalisht 20** persona nga të cilët të paktën 1 (një) punonjës duhet të jetë i punësuar si Inxhinier druri i pajisur me *diplome dhe kontratë pune e vlefshme të përfshirë në listepagese*. Për stafin e punonjësve ofertuesi duhet të paraqesë:
- *Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore.*
  - *Listepagesat për periudhën janar - gusht 2018.*
3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, ne rast se nuk është prodhues i mobiljeve të drurit, duhet të paraqesë **një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese e mobiljeve dhe vendi i origjinës**.
- 3.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës, ne rast se nuk është prodhues i mobiljeve të drurit duhet të ketë të punësuar për periudhën janar - gusht 2018 një **staf punonjësish minimalisht 10** persona, për të cilët duhet të paraqesë:
- *Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore.*
  - *Listepagesat për periudhën janar - gusht 2018.*
4. Për artikujt që nuk janë prodhime druri (grila, veshje muri, etj), operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë ku të përcaktohet kompania prodhuese dhe vendi i origjinës së tyre**.
5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **minimumi 2 (dy) mjete transporti mallrash**, me peshë ngarkese transporti të paktën 1 ton. Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qira.
- Per mjetet në pronësi të paraqiten:
- *Certifikatat e pronësisë,*
  - *lejet e qarkullimit,*
  - *kontrolli teknik,*
  - *taksat e paguara,*
  - *siguracioni.*
- Per mjetet me qira paraqiten:
- *Kontrata të lidhur përpara Noterit,*

## Dokumentat Standarde të Tenderit

- *Certifikatat e pronesisë së qiradhënësit,*
  - *lejet e qarkullimit,*
  - *kontrolli teknik,*
  - *taksat e paguara,*
  - *siguracioni.*
6. Operatori ekonomik duhet të lëshojë **një deklaratë për periudhën 1 vjecare të garancisë** së mallrave që kërkohen të prokurohen, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin, mirembajtjen dhe shërbimin pa pagesë, të defekteve për shkak të prodhimit dhe montimit.
7. Operatori ekonomik duhet të disponojë ambjente prodhimi ose magazinimi, me sipërfaqe të paktën 300 m<sup>2</sup>. Per kete operatori duhet të paraqese **çertifikate pronesisë ose kontrate qeraje te ambientit si dhe foto te ambienteve te punës.**
8. Operatori ekonomik duhet të paraqese **nje deklarate me ane te se ciles merr persiper te kryeje shërbimin e transportit, montimit si dhe vendosjen neper vende te te gjithë artikujve ne adresat e autoriteteve kontraktore**, te perfshira ne kete procedure prokurimi.
9. Operatori ekonomik të paraqesë **katalogë / broshura / foto ilustruese ose cdo lloj dokumentacioni tjetër teknik**, ku të paraqiten specifikimet teknike të secilit artikull që oferton.

### Shënim:

- **Operatori ekonomik duhet të plotësoj të gjitha tabelat, si tabelën e përgjithshme dhe tabelat e veçanta të autoriteteve kontraktore me të dhënat e paraqitura dhe për artikuj të njëjta të ofertojë me çmim të njëjtë, në të kundërt oferta e tyre do të konsiderohet e pavlefshme.**

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

Shtojca 10

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### 1. Banak për reception

## Dokumentat Standarde të Tenderit

Përmasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 250 x 70 x 110 cm

Banaku përbëhet nga syprina e madhe 250 x 70 cm mbi të cilën qëndron syprina e vogël në lartësinë 38 cm me dimensione 250x30 cm. E gjithë mobilja do të ndërtohet me material melamine 25mm. Ato kanë veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Anësorja dhe ballorja e banakut do të ndërtohet po me të njëjtin material. Në të njëjtin plan, në lartësinë 38 cm nga syprina e madhe vendoset syprina e vogël me dimensione 30 x 250 cm, e cila është pjesë e mbështetjes së klientit. Te gjithë elementet e banakut të recepsionit të jenë të borduara me material plastik PVC. Pjesë e recepsionit është dhe një sirtarierë e lëvizshme, specifikimet teknike të së cilës i kemi dhënë më vete. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **2. Dollap metalik me dyer**

Përmasat(gjerësi x thellesi x lartësi): 92 x 40 x 195 cm

Dollap metalik me dyer duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyster që të rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Hapesira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenët ndahet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **3. Dollap metalik me dyer (hapje forme flamuri)**

Përmasat(gjerësi x thellesi x lartësi): 92 x 40 x 195cm

Dollap metalik duhet të ketë strukturë prej çeliku të lyster që të rezistojë korozionit dhe përkuljes. Dollapi duhet të sigurojë mbyllje me çelës. Dyerat janë me hapje në formë flamuri. Hapesira e brendshme e dollapit ndahet në 5 hapësira. Sergjenët ndahet të kenë përshtatje lartësie jo më shumë se 30 mm dhe të kenë aftësi mbajtëse jo më pak se 50 kg. Këmbët e dollapit duhet të kenë mundësi nivelimi.

Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **4. Dollap për dosje dy kanatësh**

Përmasat(gjerësi x thellesi x lartësi): 80 x 45 x 180 cm

Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenët do të jenë prej materiali melaminë me trashësi 2.5 cm. Materiali i këtyre veshjeve laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Bordet anësore të skeletit, sergjenët dhe kanatet të jenë të veshura (bordura) me material plastik PVC. Kanatet të mbyllën me çelës. Pjesa e brendshme të ndahet në 5 (pesë) hapësira me sergjenë me mundësi regjistrimi sipas nevojës. Dorezat e kanatëve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë.



Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **5. Dollap rrobash për zyra (dy kanata)**

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 90 x 55 x 200 cm

Skeleti dhe kanatet duhet të jenë prej materiali melaminëme trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali te kete veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të skeletit dhe kanateve të jenë të veshura (borduara) me material plastik PVC. Kanatet të mbylljen me çeles. Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarjeqe formojne dy hapësira ne pjesen e poshme. Të jetë i paisur me tapa plastike kunder gervishtjes. Dorezat e kanateve dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **6. Dollap rrobash për zyra (një kanat)**

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 45 x 55 x 200 cm

Skeleti dhe kanati duhet të jenë prej materiali melaminëme trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Materiali te kete veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore te dukshme të skeletit dhe kanatit të jenë borduara me material plastik PVC. Kanati të kete mbyllje me çeles. Në pjesën e brendshme të ketë tub për varjen e rrobave dhe ndarje qe formojne dy hapësira ne pjesen e poshme. Të jetë i paisur me tapa plastike kunder gervishtjes. Dorezat e kanatit dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **7. Etazhier per zyre e veçante**

**Permasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 530 x 35 x 125 cm**

Syprina e etazhierit te jete prejmaterial melamineme spesor 32 mm. Kapaket duhet te jene xhami te temperuar me telajo (kornize) melamine. Etazhieri ndahet ne dy hapësira nepermjet sergenit i cili ka spesor 25 mm. Faqet (bordet) anësore te materialit të jenë të borduara me material plastik PVC.

### **8. Karrike per salla konferencash**

Karriket të jenë dizenuar me një stil modern me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30x15 mm dhe spesor jo me te vogel se 1.3mm dhe lyster me boje elektrostatische. Shpinorja dhe ndenjësja në pjesën e brendshme kanë një kompesatë të kurbuar. Karriget kane krahe ne dy anet e saj dhe ne krahun e djathte vendoset nje tavoline e vogel, e levizshme, per te shkruar. Ndenjesja dhe shpinorja montohen në skeleton metalik me vida. Shpinorja dhe ndenjësja kane mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë

së parë ose lëkure ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## **9. Karrike rrotulluese Zyre**

Karriket rrotulluese të keneshpinore të regjistrueshme me mekanizëm për ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli prej materiali plastik me 5 rrota në ekstremet e tyre. Rrotat të jenë me material plastik ngarkesë-mbajtës. Krahët mbështetës të karrikes të jenë plastikë dhe ngarkesë mbajtës. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## **10. Karrige të renda tip kolltuku**

Ulësja dhe mbështetësja e karrigeve tip kolltuku duhet të jenë të ndërtuara me materiale të buta që gjatë përdorimit të marrin formën e trupit duke siguruar në këtë mënyrë një qëndrim të rehatshëm kur përdoren për një kohë të gjatë. Përmasat duhet të jenë mbi kufirin minimal standard duke pasur parasysh kohën e gjatë të përdorimit. I gjithë materiali i butë është i instaluar në strukturën mbajtëse të ndenjësës dhe i mbuluar me materiale veshës.

Mbështetësja e shpinës duhet të jetë e pajisur me elemente që sigurojnë një ndenje komforte dhe njëkohësisht janë pjesë e integruar e dizajnit të vetë ndenjësës.

### **a) Komponentë të ndenjësës**

E gjithë njësia ulëse dhe mbështetëse duhet të mbështetet në një strukturë të drunjtë të rende jo shumë e lehtë për tu levizur gjithë struktura mbajtëse e ndenjësës duhet të jetë dru me një ngjyrë që do të përcaktohet në lidhje të kontratës

### **b) Mbështetëset e krahëve**

Mbështetëset e krahëve të sigurojnë një komfort gjatë përdorimit.

Struktura mbajtëse do të jetë druri të spesoreve të ndryshme për të siguruar qëndrueshmërinë statike të ndenjësës.

Ndenjeset do të jenë me krahe anesore.

### **c) Materialet**

Materiali veshës i ndenjësës duhet të jetë me tekstil të thurur me dendësi të lartë që të sigurojë një durueshmëri ndaj veprimeve mekanike të zjarrit dhe mos të deformohet, e kategorisë së lartë sipas kërkesës së investitorit.

Modeli, materialet dhe ngjyrat e çdo tipi ndenjësëje aprovohet një herë nga investitori dhe me pas vendoset në vepër.

## **11. Karrike të thjeshta zyre**

Karriket të jenë dizenuar me një stil modern. Me skelet metalik prej tubash çeliku me profil oval 30 x 15 mm me spesor jo më të vogël se 1.3 cm me lysterje elektrostatische. Në pjesën e brendshme ndodhet një material plastik i cilësisë së lartë. Shpinorja dhe ndenjësja janë material plastik i cilësisë së lartë. Në pjesën e mbrapme kanë një mbulesë prej polietileni. Montohen në skelet metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë.

Tapiceria të jëtë në stof të cilësisë së parë ose lëkure ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## 12. Karrige tip kinema

Ulësja dhe mbështetësja duhet të jene të ndërtuara me materiale të buta që gjatë përdorimit të marrin formën e trupit duke siguruar në këtë mënyrë një qëndrim të rehatshme kur përdoren për një kohë të gjatë. Përmasat duhet të jene mbi kufirin minimal standart duke pasur parasysh kohën e gjatë të përdorimit. I gjithë materiali i butë është i instaluar në strukturën mbajtëse të ndenjësës dhe i mbuluar me materiale veshës. Mbështetësja e shpinës duhet të jete e pajisur me elemente që sigurojnë një ndenje komforte dhe njëkohësisht janë pjesë e integruar e dizajnit të vetë ndenjësës.

### a) Komponentë të ndenjësës

E gjithë njësia ulëse dhe mbështetëse duhet të mbështetet në një strukturë metalike që është e fiksuar në dysheme dhe është statike, e palëvizshme (si ndenjëset e teatrit).

Pjesa e pasme e mbështetësës duhet të jete e veshur me të njëjtin material që është veshur edhe pjesa tjetër e ndenjësës duke siguruar kështu një pamje estetike edhe nga shikuesit prapa.

Ndenjesja duhet të ketë maknizmin e mbylljes në rastet kur nuk ulet person në të.

### b) Mbështetëset e krahëve

Mbështetëset e krahëve duhet të jene elegante dhe të sigurojnë një komfort gjatë përdorimit.

Ndenjeset do të jene me krahe anesore, të mbushur.

Struktura mbajtëse do të jete druri të spesoreve të ndryshëmose plastike e derdhur në forme anatomike. Për të siguruar qëndrueshmërinë statike të ndenjësëve skeleti mund të jenë metalike, (çelik ose duralumin) por në çdo rast duke mos cenuar pamjen estetike të saj.

### c) Materialet

Materiali veshës i ndenjësës duhet të jete poliprepilen plastik me dendësi të lartë që të sigurojë një durueshmëri ndaj veprimeve mekanike dhe mos të deformohet ose cope të kategorisë së parë, rezistent ndaj zjarrit, sipas kërkesës së investitorit.

Ngjyra e preferuar është vishnje.

Pjesët e tjera përbërëse janë të ndërtuara me material druri ose metalike (çelik ose duralumin). Modeli, materialet dhe ngjyrat e çdo tipi ndenjësëje aprovohet një herë nga investitori dhe me pas vendoset në vepër.

**SHEMBUJ TË MUNDSHËM**



- Karriget te jene te lidhur ne sistem dysh apo tresh sipas konfigurimit dhe hapësires ku do te vendosen.

Shënim: Modelet e shembujve janë udhërrëfyese.

### 13. Kasaforta sekrete

Përmasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 50 x 50 x 110 cm

Kasaforta duhet te ketestrukture llamarinë me trashësi jo më pak se 1.5 mm. Të ketë dy ndarje horizontale nga brenda, ku të krijohen tre hapësira. Dera të jetë e paisur me dorezë dhe bravë automatike sekrete. Lyerja me mënyrë elektrostatische. Bazamenti të jetë jo më pak se 10 cm. Kasaforta të ketë paraqitje estetike dhe saldimet të mos shikohen në pjesën e jashtme.

### 14. Kolltuqe komplet (3+2+1)

Skelet druri, stil modern dhe tapiceri me lëkurë ekologjike. Mbushje me sfungjer cilesor. Modeli, seti, ngjyra, etj do te percaktohet nga Autoriteti Kontraktor ne momentin e lidhjes se kontrates. Ne komplet do te jene nje 3 vendesh nje 2 vendesh dhe nje kolltuk tek.

### 15. Krevat tek

(Përmasat (gjatësi x gjerësi): 190x90 cm

Materiali i përdorur do jetë melaminëme trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë

kundër gërvishtjeve dhe njollave. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuaraveshura me material plastik PVC. Koka e krevatit të jetë me permasa 80 x 90 cm, ndersa fundi me permasa 40 x 90 cm). Krevati do të jetë i pajisur me radice druri të stazhonuar për mbajtjen e dyshekut. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

#### **16. Pedanë për sallë mbledhjesh**

Përmasat(gjatesi x gjerësi x lartësi): 300 x 200 x 20 cm

Materiali i përdorur për strukturën e pedanës do të jetë pllakë zdrukthi (me spesor jo më pak se 16 mm). Pjesa e brendshme e saj do të ndërtohet me të njëjtin material të cilat do të montohen në mënyrë vertikale duke formuar disa fole. Pjesa e dukshme e kësaj strukture do të vishet me parket laminat. Pedana do të jetë e ndarë në 3 pjesë 100 x 200 x 20 cm, kjo për efekt transporti. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

#### **17. Poltron pritje dyvendësh (kolltuk dyvendësh)**

Të jetë me skelet druri.Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern.Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë.Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

#### **18. Poltron pritje njëvendësh (kolltuk njëvendësh)**

Të jetë me skelet druri.Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern.Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës

#### **19. Poltron rrotullues (drejtuesi)**

Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë.Me një mekanizëm që lejon fiksimin e pozicioneve të ndryshme të përshtatshme në ulje.Shpinorja duhet të jetë e përshtatshme në pozicionet vertikalisht si dhe para e prapa.Duhet të ketë krahë anësore.Të ketë përshtatëse piston me gaz për nivelimin e lartësisë.Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur.Bazamenti duhet të jetë metalikose plastik me 5 degëzime në formë ylli dhe me rrota sferike në ekstremet e tyre. Ngjyrat e tapicerisë janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

#### **20. Poltron statik për tavoline mbledhje**

Me tapiceri prej lëkure ekologjike, me shpinore të lartë.Të ketë krahë anësore.Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbehet prej një tubi petashuq i kromuar i cili përshkon shpinën në dy anet e saj, ndenjesën dhe zbret në tokë duke u mbyllur në formë U, duke luajtur dhe rolin e bazamentit.

#### **21. Raft metalik për arkivë**

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 100 x 42 x 250 cm

Materiali i përdorur për këmbët do të jetë profil katror 30 x 30 x (me spesor) 1.6 deri 1.8 mm. Materiali i përdorur për vendosjen (sergjenat) e dosjeve do të jetë llamarinë e zezë me spesor 1.2 mm. Rafti do të ketë dhe një platformë melamine me shinë që do të shërbejë për një shikim të shpejtë të dosjesne vend. Ngjyra e raftit do të jetë gri metalizato.

## **22. Raft për dosje (etazher)**

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 90 x 45 x 190 cm

Skeleti dhe sergjenët do jenë prej material melaminëme trashësi 2.5 cm. kapaket jane me material MDF te plastifikuar me pvc me spesor jo me pak se 1.6 deri 18 mm. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kapakëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Poshtë fiankeve do ketë tapa fundore kunder gervishtjes. Në pjesën e poshtme deri në lartësinë 72 cm, do të ketë dy kapakë prej material dru-melaminë, me trashësi jo më të vogël se 1.8 cm që mbyllën me çelës. Dollapi brenda këtyre dy kapakëve do jetë i ndarë në dy pjesë me anë të një sergjeni me lartësi të regjistrueshme. Pjesa e sipërme është e mbyllur me kapakë xhami (që mund të jenë me ose pa kurnizë druri ose metali). Hapësira brenda kapakëve të xhamit do ndahet në tre hapësira me anë të sergjenëve që janë të regjistrueshëm sipas nevojës. Dorezat dhe aksesorët e përdorur të jenë cilësorë mundësisht prej metali te kromuar. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## **23. Sirtarierë e lëvizshme me rrota**

Përmasat(gjeresi x thellesi x lartesi): 45 x 53 x 60 cm lartësi (se bashku me rrotat)

Struktura e sirtarierës do jetë melaminë me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishetjeve dhe njollave. Syprina dhe kapaket ballore te sirtareve duhet te jene prej material melamine me spesor. Bordet anësore, fiankeve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Sirtariera duhet të ketë 4 rrota sferike në fund dhe të mund të lëvizë nën tavolinë. Sirtari i pare nga lart duhet të jetë më i vogël dhe i përshtatur për të mbajtur sende të imëta, pjesa tjetër të ndahet në 3 sertarë të barabartë. Sirtarët duhet të jenë të paisur me kyç që të realizojë mbyllje qendrore. Aksesorët e përdorur duhet të jenë cilësorë, në mënyrë që të sigurojnë një qëndrueshmëri të lartë të sirtarierës. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## **24. Tavolinë e madhe mbledhjesh**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): **280 x 105 x 72 cm**

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë te lartë kunder gërvishetjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës (syprines) dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës (syprines) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së

kontratës.

## **25. Tavolinë e mesme mbledhjesh**

### **Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): 255 x 170 x 72 cm**

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës (syprines) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 165 x 80 cm që vendosen paralalisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 170 x 45 cm, dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale.

## **26. Tavolinë ovale për sallë mbledhjesh**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): 680 x 210 x 72 cm

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të suprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina e tavolinës përbëhet nga 6 elementë. Kater elementë me përmasa 2350 x 70 cm që vendosen paralalisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 70 cm midis tyre, dy elementët e tjerë janë në përmasa 210 x 105 cm, dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

## **27. Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): **200 x 90 x 72 cm**

Plani i sipërm, syprina, duhet të jetë melamine 2.5 cm. Spesoret anesor janë material melamine. Tavolinaduhet të jetë lehtësisht e çmontueshme.

## **28. Tavolinë e vecantë për sallë mbledhjesh**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): **350 x 170 x 72 cm**

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës (syprines) me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë.

Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Syprina e tavolinës përbëhet nga 4 elementë. Dy elementë me përmasa 180 x 80 cm që vendosen paralalisht me njëri tjetrin duke lënë një hapësirë 10 cm midis tyre. Dy elementët e tjerë janë në përmasa 170 x 85 cm, dhe janë në formë gjysmërrethi. Duke u vendosur përballë njëra tjetrës, në dy anët e ngushta të dy elementëve të parë i japin tavolinës një pamje ovale. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **29. Tavolinë e vogël mbledhësh**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): 180 x 105 x 72 cm

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me plane me të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **30. Tavolinë mes**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): **110 x 55 x 45 cm**

Materiali i përdorur do të jetë MDF e rimesuar. Syprina në pamjen ballore të saj do të jetë 10 cm. Këmbët e tavolinës përbëhen nga i njëjti material me atë të suprinës dhe janë të përmasave 10 x 10 x 35 cm. Ato montohen në skajet e suprinës së tavolinës dhe duhet të garantojnë një qëndrueshmëri të lartë, sidomos në pozicionin rrëshqitës. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **31. Tavolinë për dhomë**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): 60 x 60 x 70 cm

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Syprina qëndron mbi 4 këmbë druri të lidhura me njëra tjetrën dhe suprinën, në mënyrë estetike dhe solide. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **32. Tavoline pune**

Përmasat (gjatesi x gjeresi x lartesi): **180 x 80 x 72 cm**

Syprina melaminë me trashësi 32 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC.



Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues.

### **33. Tavolinë pune e thjeshtë**

Përmasat (gjatesi x gjerësi x lartësi): **140 x 80 x 72 cm**

Syprina melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Këmbët janë me planë të të njëjtit material dhe trashësi të syprinës. Bordet anësore të planit të punës dhe të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide. Pjesa ballore është e pozicionuar e tillë që realizon bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Në pjesën e brendshme në njerin krah ndodhet posti i tastierës e fiksuar me shina rrëshqitëse, në krahun tjetër ndodhen dy sirtare me gjerësi 45 cm ku sirtari I parë të jetë I mbyllur me çelës. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **34. Tavolinë pune e thjeshtë në formë L**

Përbëhet nga 3 pjesë kryesore

- Tavolinë pune (gjatesi x gjerësi x lartësi) 140 x 80 x 72 cm
- Tavolinë kompjuteri (gjatesi x gjerësi x lartësi) 90 x 80 x 72 cm
- Hark lidhës 90 ° me përmasa 80 x 80 cm.

Harku lidhës 90 ° me përmasa 80 x 80 cm. Materiali dhe karakteristikat janë të njëjta me tavolinën e punës dhe të kompjuterit. Bën të mundur lidhjen organike të tavolinës së punës me tavolinën e kompjuterit. Në pjesën fundore të këmbëve montohen këmbë niveluese. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **35. Tavolinë pune rang drejtuesi**

Përmasat (gjatesi x gjerësi x lartësi): 180 x 80 x 72 cm.

Suprina melaminë me trashësi 32 mm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Syprina është me material melaminë me trashësi (spesor) 32 mm e plastifikuar me PVC. Këmbët janë me material melaminë dhe trashësi të njëjta me ato të syprinës. Bordet anësore të këmbëve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Bashkimi i

planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë që i jep tavolinës pamje solide dhe të rëndë. Pjesa ballore është e pozicionuar në menyre të tillë që të realizojë bashkimin e planit të punës me këmbët e tavolinës dhe qëndron në një hapësirë 40 cm, nga plani i dyshemesë. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Në planin e punës të jetë e hapur një vrimë, në të cilën fiksohet një mekanizëm plastik në formë cilindri dhe bën të mundur kalimin e kabllave nga lart poshtë dhe anasjelltas. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **36. Tavolinë pune rang drejtuesi në formë L**

Përbëhet nga 3 pjesë kryesore

- Tavolinë pune 180 x 80 x 72 cm
- Tavolinë kompjuteri 90 x 80 x 72 cm
- Hark lidhës 90 ° me përmasa 80 x 80 cm

Materiali dhe karakteristikat e të gjithë elementeve perberes do të jenë të njëjta me tavolinën e punës rang drejtuesi dhe tavolinën e kompjuterit. Hark lidhës 90 ° me përmasa 80 x 80 cm bën të mundur lidhjen organike të tavolinës së punës me tavolinën e kompjuterit. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **37. Tavolinë referimi salle (foltore)**

Përmasat (gjerësi x thellesi x lartësi): 80 x 60 x 125 cm

Materiali i përdorur melaminë me trashësi 2.5 cm. Veshje laminati me rezistencë të lartë kundër gërvishjeve dhe njollave. Fianket (Faqet anesore) bashkohen me pjesën ballore në formë U. Plani i leximit vendoset në mënyrë të tillë që bordet e sipërme të fiankeve (faqeve anesore) dhe balloret të jenë 7 cm më lart. Bordet anësore të elementëve përbërës të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Në pjesën e poshtme të fiankeve (faqeve anesore) të montohen këmbëza niveluese. Aksesorët që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **38. Varesë rrobash + mbajtëse çadrash (e levizshme)**

Struktura duhet të ketë një bazament rrethor me diametër jo më të vogël se 30 cm. Të ketë 8 vende për të varur rroba dhe një vend bashkangjitur për çadra. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

### **39. Makinë grirëse letre**

Makineri standard për grirje letre. Shiriti i letrës të jetë maksimumi 4 mm, prerje e drejtë. Garancia minimumi 12 muaj.

#### **40. Pasqyre muri per tualet**

Permasa 80x60 cm, te jene me korniza druri. Xhami i pasqyres te jete i cilesise se larte. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Montimi sipas kerkesave te AK.

#### **41. Karrige statike pa krahë**

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq ovale 30 x 15 mm me spesor jo me te vogel se 1.3 mm, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësen. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Lyerja me boje elektrostatische. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.



#### **42. Kosh letrash**

#### **43. Ndricules statik**

#### **44. Ndricules tavoline**



#### **45. FV : Veshje Muri**

Pllaka druri te bute (paulaënia, ose zdrukthi), dru i lehte per t'u perdorur me pineska, trashesia 16-20mm.

#### **46. Reception**

MDF i lyer, modeli sipas vizatimit.


# Dokumentat Standarde të Tenderit




## 47. Garderobë

MDF i lyer, modeli sipas vizatimit.

Pamja




Planimetria




### 48. Tavolinë tip 1

Suprine druri te lehte (paulaënia, ose zdrukthi), 70x140x0.2cm, mbeshtetur ne skelet (kub) metalik te zi, me profil katror 20mm, 70x140x73cm (tavolina e perfunduar h=75cm).



### 49. Tavolinë tip 2


Transparente, plexiglass pa ngjyre, 70x140x75cm.



### 50. Ekspozitorë


Dy panele druri te lehte (paulaënia, ose zdrukthi), orientimi horizontal, me permasa secila 90x220cm, te kapura ne brinjen e ngushte me 2-3 mentesha metalike estetike, dhe te montuara me hapje/kend 15 grade me njera-tjetren, dhe te lidhura ne bazament per qendrushmeri. Secili panel ka te montuar 4 xhepa horizontale (90 cm

te gjate dhe 12 cm te gjere) te vendosur me 50 cm largesi njeri nga tjetri gjate gjithë lartesisë se panelit.



### 51. Ulëse

Transparente, plexiglass pa ngjyre, 70x140x45cm



### 52. Karrige

Elegante, te zeza, plastike dhe kompakte, me kembe metalike te zeza, me forma kuadratike.

### 53. Karrige statike pa krahë, drejtuesi (tavoline mbledhje)

Karriget të jenë dizenuar me një stil modern. Thellësia e ulëses e përshtatshme për përdorues të rritur. Skeleti përbëhet prej një tubi petashuq të kromuar, i cili përshkon shpinoren në dy anët e saj dhe ndenjësen. Montohen në skeletin metalik me vida. Me mbushje gome sintetike me densitet të lartë. Tapiceria të jetë lëkurë ekologjike. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do

të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

**54. Kolltuk pritje dyvendësh, drejtuesi**

Të jetë me skelet metalik ose dru. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

**55. Kolltuk pritje njëvendësh, drejtuesi**

Të jetë me skelet metalik ose dru. Të jetë i dizenuar me linja të drejta të stilit modern. Me tapiceri prej lëkure ekologjike të një cilësie të lartë. Sfungjeri i përdorur të jetë cilësor. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

**56. Librari për dosje e hapur, rang drejtuesi**

Skeleti dhe kanatet do jenë prej materiali dru-mdf- melamine me trashësi 1.6 deri 1.8 cm. Sergjenët do jenë prej materiali dru-mdf- melamine me trashësi 2.5 cm. Veshje MDF me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Xokula do jetë 2 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit, sergjenëve dhe kanateve të jenë të harkuara. Montimi dhe zmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi i saktë i tyre do të bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës.

**57. Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 12 persona**

Suprina MDF, jo e shkëlqyeshme pa venatura druri me trashësi 4 cm, me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe njollave. Këmbët janë inox. Bordet anësore të planit të punës të jenë të harkuara. Bashkimi i planit të punës me këmbët bëhet në mënyrë të tillë, që i jep tavolinës pamje solide. Aksesoret që përdoren për montimin e elementëve të tavolinës të jenë cilësorë. Këmbët të jenë me mekanizëm nivelues. Montimi dhe çmontimi të jetë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit. Ngjyrat do të caktohet në kushtet e lidhjes së kontratës.

**58. Tavolinë mbledhje rang drejtuesi, 6 persona**

